



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA E TIRANËS**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**

[Dt19.12.2022]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

**OPERATORIT EKONOMIK “SOFT & SOLUTION” SHPK**

Adresa: Tirane Rruga: "Tefta Tashko", Pazari i Ri, Nr. 185, Njesia Administrative Nr. 2

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Sistemi elektronik për mbledhjen dhe menaxhimin e informacionit për fermerët në hapësirën territoriale të Bashkisë Tiranë” me Nr. reference REF-48177-11-01-2022** për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (*njoftimi i kontratës*): Buletini Nr. 152 datë 7 Nëntor 2022

Publikimet e mëparshme (*njoftimi i fituesit paraprak*): Buletini Nr. 170 datë 12 Dhjetor 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

- **Operatori ekonomik “INSTANT.AL” sh.p.k, NIPT L81506043D**

Vlera e ofertës pa tvsh = 13,000,000 (trembëdhjetë milion) lekë.

- **Operatori Ekonomik “HELIUS SYSTEMS” sh.p.k, NIPT K19607030D**

Vlera e ofertës pa tvsh= 13,600,000 (trembëdhjetë milion e gjashtëqind mijë) lekë

- **Operatori Ekonomik “FASTECH” sh.p.k, NIPT J81609010U**

Vlera e ofertës pa tvsh= 16,104,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e katër mijë) lekë.

- **Operatori ekonomik “SOFT & SOLUTION” sh.p.k, NIPT L11328009F**

Vlera e ofertës pa tvsh = 15,913,575 (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

### **1. Operatori ekonomik “INSTANT.AL” sh.p.k, NIPT L81506043D**

#### Për arsyet e mëposhtme:

I. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar ka kërkuar:

*“2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, ku vlera e xhiros minimale për vitet financiare 2019,2020,2021, të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.”*

Operatori Ekonomik në referencë të kriterit të sipërcituar ka paraqitur vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë për xhiron e 3 (tre) viteve financiare 2019,2020,2021, nga ku rezulton se nuk përmbushen kërkesat e kriterit të sipërcituar për asnjë prej viteve financiare përkatëse, pasi vlera e asnjë viti nuk arrin minimalisht vlerën e kontratës që prokurohet, duke mos përmbushur kështu kërkesat e kriterit 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar të DST.

II. Referuar pikës 2.3 Kapaciteti teknik të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, konkretisht kriterit:

*2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të*

vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Operatori ekonomik "INSTANT.AL" sh.p.k nuk ka paraqitur dëshmi për përvojën e mëparshme sipas kërkesave të kriterit të mësipërm.

Konkretisht, për shërbimet e realizuara me entet publike, operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetime të lëshuara nga entet publike për përmbushjen me sukses të kontratave respektive.

Ndërsa për shërbimet e realizuara me sektorin privat konkretisht me subjektin "Albanian Parcel Distribution", vlera respektive e faturës së paraqitur nuk përmbush 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Referuar sa më sipër, KVO gjykon se operatori ekonomik "INSTANT.AL" sh.p.k, nuk përmbush kërkesat e kriterit 2.3.1 të kapacitetit teknik të DST.

### III. Në pikën 2.3.4 të Kapaciteti teknik pjesë e Kriereve të Vecanta të Kualifikimit, AK ka kërkuar:

... "2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një personel teknik të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Informatikë Matematikë, Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatikë Ekonomike, Telekomunikacion, Inxhinieri Telekomunikacion ose ekuivalente, që do të angazhohen në implementimin e projektit, me këto kompetenca:

a. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente.

b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalente.

c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Solution Developer për Aplikime në ëeb ose ekuivalente.

d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Microsoft Specialist në Programming HTML5 me Java Script dhe CSS3 ose ekuivalente.

e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për DBA (Database Administrator) për administrimin e bazës së të dhënave ose ekuivalente.

f. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Testues Programi ose ekuivalente.

Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikata.

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- *Certifikata për specialistët e kërkuar;*
- *Diplomat ose vërtetime nga universitetet përkatëse;*
- *Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;*
- *Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B.”*

Operatori ekonomik “INSTANT.AL” sh.p.k në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit , në sesionin “ *Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)*” ka deklaruar:

*Profili i punonjësve: Programues, zhvillues softëare, ëbmaster etj.*

Operatori ekonomik “ONI” sh.p.k ka deklaruar:

*Profili i punonjësve:*

*Inxhnier elektronik*

*Inxhinier mekanik*

*Inxhinier informatik*

*Inxhinier IT*

*Inxhinier informaticien*

*Inxhinier Informatik (programues)*

*Inxhinier Elektronik, Informatik për mirëmbajtjen e kompjuterave*

*Inxhinier Elektronik, Informatik për infrastrukturën e rrjetit.*

*Informaticien ose Inxhinier Informatik (programues).*

*Punonjës të diplomuar në shkenca elektronike, në shkenca kompjuterike, në shkenca informatike dhe specialiste të certifikuar për CCNA, për CCNP, PROGRAMUES/ZHVILLUES, specialist të certifikur për DATA BAZE, për Softëare Development fundamentals, Database Fundamentals etj,*

*Softëare Development Fundamentals*

*Database Fundamentals*

*Health Information Exchange Certified Developer*

*CISCO CERTIFIED NETËORK ASSOCIATE ROUTING AND SËITCHIND- CCNA*

*CISCO CERTIFIED NETËORK PROFFESIONAL ROUTING AND SËITCHING- CCNP”*

Për sa më sipër cituar, referuar profilit dhe certifikimeve të deklaruara nga të dy operatorët, asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar se disponon staf të certifikuar me kompetencat minimalisht sipas pikave:

*a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente.*

*b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalente.*

*f) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Testues Programi ose ekuivalente.*

**Në vijim të arsyetimit, KVO gjykon se operatori ekonomik “INSTANT.AL” sh.p.k, nuk ka përmbushur kërkesat sipas pikave 2.2.1, 2.3.1, dhe 2.3.4/a, 2.3.4/b, 2.3.4/f, të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST).**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ( i ndryshuar), Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

- **Operatori ekonomik "HELIUS SYSTEMS" sh.p.k, NIPT K19607030D**

Për arsyet e mëposhtme:

I. Autoriteti Kontraktor, në pikën 1/a të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit kërkon:

*Ofertuesi duhet të paraqesë:*

*"a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9."*

Operatori ekonomik "HELIUS SYSTEMS" sh.p.k, nuk ka paraqitur dokument në spe për përmbushjen e kriterit 1/a të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.

Në vijim të sa më sipër KVO gjykon se si rrjedhojë e sa më sipër, operatori ekonomik nuk ka plotësuar kriteret që përmbushen me paraqitjen nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit, konkretisht:

Në pikën 2 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit AK kërkon:

*"2. Ofertuesi duhet të paraqesë:*

*2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:*

*Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9."*

Në pikën 2.3.4 të Kapacitetit teknik AK kërkon:

*"2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një personel teknik të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Informatikë Matematikë, Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatikë Ekonomike, Telekomunikacion, Inxhinieri Telekomunikacion ose ekuivalente, që do të angazhohen në implementimin e projektit, me këto kompetenca:*

- a. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente.*
- b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalente.*
- c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Solution Developer për Aplikime në ëeb ose ekuivalente.*
- d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Microsoft Specialist në Programming HTML5 me Java Script dhe CSS3 ose ekuivalente.*
- e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për DBA (Database Administrator) për administrimin e bazës së të dhënave ose ekuivalente.*
- f. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Testues Programi ose ekuivalente.*

***Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikata.***

*Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- *Certifikata për specialistët e kërkuar;*

- *Diplomat ose vërtetime nga universitetet përkatëse;*
- *Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilitin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;*
- *Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi, paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B.”*

**Meqenëse kriteret e sipercituara, në këtë fazë të vlerësimit përmbushen nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, KVO konkludon se Operatori ekonomik “HELIUS SYSTEMS” sh.p.k, nuk përmbush kërkesat e pikës 1. Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, kërkesat e pikës 1/a, dhe 2.3.4 të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit.**

II. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik pjesë e Kritereve të Vecanta të Kualifikimit kërkon:

...“

**2.3.3** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë markën, modelin shoqëruar me katalogë ose broshura për tabletët që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme e specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre). Fleta ose fletët e katalogut/broshurës që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara...”*

**Operatori Ekonomik “HELIUS SYSTEMS” sh.p.k, nuk ka paraqitur dokument vërtetues për përmbushjen e kërkesave të pikës 2.3.3 të Kapacitetit teknik, pjesë e kritereve të vecanta të kualifikimit .**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ( i ndryshuar), Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

▪ **Operatori ekonomik “FASTECH” sh.p.k, NIPT J81609010U**

*Për arsyet e mëposhtme:*

I. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik kërkon:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës **dhe faturave tatimore** të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Operatori Ekonomik “FASTTECH” sh.p.k nuk ka paraqitur fatura tatimore në spe për të vërtetuar realizimin e shërbimeve të ngjashme sipas kërkesave të kriterit 2.3.1 të dokumentave standarde të tenderit.

**Sa më sipër, KVO konkludon se operatori ekonomik “Fastech” sh.p.k nuk ka përmbushur kërkesat e kriterit 2.3.1 të kapacitetit teknik pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, të dokumentave standarde të tenderit, për këtë procedurë prokurimi, objekt vlerësimi.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ( i ndryshuar), Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**SOFT & SOLUTION**” shpk, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 15,913,575 (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë me adresë Blv “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JOX

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)\_\_\_\_\_